



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.666/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gradanska Inicijativa GIZP-Milije Biševac-me seli në Zubin Potok, paraqitur kundër Dušica Stojanović, kryesues Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) -Zubin Potok, për shkak të parregullësive gjatë ditës së votimit, në QV Zubin Potok, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Gradanska Inicijativa GIZP-Milije Biševac, me seli në Zubin Potok, paraqitur kundër Dušica Stojanović, kryesues Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) -Zubin Potok, për shkak të parregullësive gjatë ditës së votimit, në Qendrën e Votimit në Zubin Potok, për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Gradanska Inicijativa GIZP-Milije Biševac, me seli në Zubin Potok, me të cilën pretendon se në Zubin Potok ka pasur Anshmëri ndaj Listës Serbe gjatë zgjedhjeve, refuzim për të ndërhyrë në raportimet e shkeljeve të dukshme të ligjit gjatë zgjedhjeve, presion mbi anëtarët e vendvotimeve (GIZP) që të heqin dorë nga paraqitja e ankesave, kërcënime ndaj anëtarëve të vendvotimeve (GIZP) se do të përgjigjen penalisht nëse nuk tërheqin ankesat me shkrim, refuzimi për të zëvendësuar anëtarët që mungonin në vendvotime edhe pse ishin të informuar se ata nuk do të vinin për shkak të problemeve shëndetësore, dhe në 2 vendvotime ishin pa vëzhgues për një orë (anëtar i komisionit të vendvotimit).

Pretenduesi i ankesës ka theksuar se nuk ka pasur ndërhyrje kur ata vazhdimisht kanë treguar se gjatë ditës ka pasur kandidat për këshilltarë nëpër vendvotime, etj.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, në QV në Zubin Potok ka

pasur anshmëri ndaj listës serbe gjatë zgjedhjeve, presion e kërcënime ndaj antarëve, nuk qëndron sepse pala nuk ka ofruar asnjë provë për të dëshmuar pretendimet në ankesë.

Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës 17.10.2021, paneli konstatoi se pretendimet në ankesë janë të pabazuara lidhur me parregullësit në Zubin Potok, ku thuhet se në vendin e ngjarjes ishte përgjigjur një njësi policore dhe kishte marrë në pyetje anëtar të komisionit komunal Zgjedhor, kryetarën e komisionit komunal zgjedhor dhe nuk ishte shënuar asnjë parregullsi, dhe se nuk është vërtetuar se ka pasur presion apo kërcënime në vendvotim. Në fund të raportit policor theksohet se oficerët e policisë dhe as Prokurori i Shtetit nuk ka hyrë në vendvotim të Qendrave të Votimit, por të gjitha intervistat i ka bërë në oborrin e shkollës fillore, ku janë caktuar vendvotimet. Në raport është theksuar se rasti do të hapet në vendvotimin Zubin Potok, dhe për veper penale “raportimi i rreme” nga neni 385 i KPK-së, dhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetimore, do të bëhet një intervistë me Milija Bisevac.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë e ka vërtetuar në mënyrë të padyshimt, se pretendimet ankimore janë të pabazuara në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë nga parashtresesi i ankesës dhe nga raporti policor theksohet se nuk është shënuar asnjë rast lidhur me parregullsit në Zubin Potok, andaj ankesa e ankuesit u refuzua si e pabazuar në kuptim të nenit 118 të LZP-së.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.666/2021 më datën 20.10.2021.

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Braçi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.